



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2015
Nr. ref.: RK 833/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMERI

në

Rastin rr. KI05/15

Parashtrues

Reshat Osmani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që
Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-14-0061, të 5
shtatorit 2014**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Reshat Osmani me vendbanim në Han të Elezit, i cili përfaqësohet nga z. Miftar Islami, avokat në Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave i DHPGJS), AC-I-14-0061, i 5 shtatorit 2014, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës si e pabazuar dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS), i 12 shkurtit 2014.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 23 shtator 2014.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI05/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI05/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 20 shkurt 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi DHPGJS-së një kopje të kërkesës.
9. Më 9 mars 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.
10. Më 23 mars 2015, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

11. Më 8 korrik 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në vitin 1963, i ati i parashtruesit të kërkesës i shiti një kooperative bujqësore 2 (dy) parcela të tokës, të cilat gjenden në komunën e Ferizajt.
13. Në bazë të shkresave të lëndës, pas ndryshimit të ligjit, në vitin 1996, i ati i parashtruesit parashtrroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Ferizaj që ta anulojë shitjen e këtyre 2 (dy) parcelave të tokës.
14. Më 23 mars 1998, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi P. nr. 287/96) duket se miratoi kërkesën e babait të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi kontratën e blerjes së vitit 1963 si të paligjshme. Përveç kësaj, Gjykata Komunale urdhëroi kooperativën bujqësore, Ndërmarrjen Shoqërore "Pasuria Bujqësore", që t'ia dorëzojë ngastrat të atit të parashtruesit të kërkesës, duke e detyruar atë që t'i paguajë një shumë të caktuar kooperativës bujqësore, si kompensim. Duket se këto dy ngastra të tokës nuk i janë transferuar asnjëherë babait të parashtruesit të kërkesës.
15. Në një moment të caktuar, i ati i parashtruesit vdiq. Si trashëgimtar legjitim, parashtruesi i kërkesës vazhdoi me padinë për kthimin e ngastrave të tokës.
16. Nga shkresat e lëndës rrjedh se ngastrat e lartpërmendura i ishin nënshtruar procesit të privatizimit nga AKP-ja.
17. Më 4 gusht 2011, parashtruesi paraqiti kërkesë në AKP për largimin e ngastrave nga procesi i privatizimit.
18. Më 17 tetor 2011, parashtruesi parashtrroi padi në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, fillimisht duke kërkuar verifikimin e pronësisë mbi 2 (dy) parcelat kadastrale, në bazë të parashkrimit fitues.
19. Më 5 dhjetor 2011, parashtruesi parashtrroi një kërkesë tjetër te Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së për urdhër paraprak gjyqësor për t'i hequr ngastrat e tokës nga procesi i privatizimit.
20. Më 19 mars 2012, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së refuzoi kërkesën e parashtruesit për urdhër paraprak gjyqësor si të pabazuar.
21. Në një datë të paspecifikuar, si rezultat i procesit të privatizimit, AKP-ja ia kishte shitur ngastrat e lartpërmendura një pale të tretë.
22. Më 10 dhjetor 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së mbajti një dëgjim publik, ku ajo ia dha mundësinë parashtruesit të kërkesës të ndryshojë ose të saktësojë padinë e tij. Gjatë dëgjimit publik, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, kërkoi ose kthimin e parcelave kadastrale, për të cilat ai pretendonte pronësinë, ose kompensimin me një tjetër ngastër të tokës për parcelat, të cilat ndërkohë i ishin shitur një pale të tretë. Sa i përket kërkesës së

dytë të parashtruesit, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, gjatë dëgjimit publik kërkoi nga parashtruesi i kërkesës ta saktësojë parcelën e tokës të cilën e kërkonte si kompensim për parcelat e shitura.

23. Më 12 shkurt 2014, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së (Aktgjykimi SCC-11-0240) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.
24. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për konfirmimin e pronësisë së tij mbi 2 (dy) parcelat kadastrale të sipërpërmendura në bazë të parashkrimit fitues, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vlerësoi se ndalimi i parashkrimit fitues kundër ndërmarrjeve shoqërore u shfuqizua në vitin 1996 dhe numërimi i afateve mund të rifillonte vetëm prej asaj kohe. Prandaj, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, duke iu referuar dispozitave të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore, konstatoi se periudha për parashkrimin fitues të pronës së tokës është 20 (njëzet) vjet. Prandaj, sipas Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, edhe në qoftë se toka nuk do t'i ishte shitur palës së tretë, parashtruesi nuk do të fitonte të drejtat e pronësisë mbi bazën e lartpërmendur ligjore.
25. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për kompensim me një ngastër tjetër të tokës, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vlerësoi se, përkundër faktit se parashtruesit i ishte dhënë mundësia për të saktësuar padinë e tij, ai nuk arriti të identifikojë tokën që ai e kërkonte si kompensim për parcelat që i ishin shitur një pale të tretë.
26. Prandaj, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së arriti në përfundim se pretendimi i parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet për shkak se është i pabazuar nga pikëpamja faktike dhe më tej konstatoi se edhe nëse padia do të ishte ndryshuar dhe saktësuar sipas kërkesës së Kolegjit të Specializuar, prapë do të konsiderohej e pabazuar, sepse kërkesat e parashkrimit fitues nuk ishin përmbushur në rastin e tij.
27. Më 16 shkurt 2014, parashtruesi parashtrroi ankesë kundër aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke kërkuar nga ky i fundit ta miratojë kërkesën e tij për kompensim me një tjetër ngastër të tokës, ose ta shfuqizojë aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së dhe ta kthejë rastin për shqyrtim dhe për rigjykim. Sa i përket konkludimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së se parashtruesi i kërkesës nuk kishte saktësuar kërkesën e tij, ai argumentoi se ishte e pamundur të identifikojë ngastrën e tokës të kërkuar si kompensim, pasi ai nuk ka pasur qasje në Shërbimin Kadastral.
28. Më 5 shtator 2014, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së (Aktgjykimi AC-I-14-0061) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.
29. Në Aktgjykimin e tij, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore (Gazeta Zyrtare e RSFJ 29/78), konstatoi se edhe në rast se Kolegji i Specializuar do t'ia kishte konfirmuar pronësinë e parcelave të pretenduara parashtruesit të kërkesës dhe AKP-ja të kishte tjetërsuar ato parcela në dëm të tij, ky i fundit do të kishte të

drejtë vetëm për një kompensim në të holla. Sipas Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, parashtruesi nuk kishte kërkuar një kompensim të tillë.

30. Prandaj, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së konkludoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës duhet të refuzohet si e pabazuar për shkak se *“mungesa e kjarhtësisë së mjaftueshme të kërkesës e pengon gjykatën të pranojë çfarëdo mjeti juridik”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Siç u përmend më lart, parashtruesi në kërkesën e tij pretendon se me aktgjykimin e Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
32. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesën e mëposhtme për kompensim *“ose tokë tjetër ose kompensim në të holla, sipas vlerës së përcaktuar nga ekspertët”*.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

34. Gjykata merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

35. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

36. Siç u theksua më lart, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës, të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

37. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi vetëm kishte përmendur dispozitat e lartpërmendura, por nuk kishte paraqitur asnjë argument apo dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.
38. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se pakënaqësia me vendimin nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese të së drejtës për një gjykim të drejtë. Kur pretendohen shkelje kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë argumente bindëse dhe të padiskutueshme për të mbështetur pretendimet, në mënyrë që kërkesa të jetë e bazuar (Shih rastin Nr. KI198/13, Parashtrues i kërkesës *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).
39. Për më tepër, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të zëvendësojë rolin e gjykatave të rregullta në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999; shih edhe rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
40. Gjykata konsideron se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së kanë kryer procedurat në mënyrë të drejtë dhe i kanë arsyetuar vendimet e tyre në bazë të padisë dhe të ankesës së parashtruesit të kërkesës. Lidhur me këtë, Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së konfirmoi se parashtruesit i ish-in dhënë disa mundësi për të saktësuar apo për të identifikuar parcelën e tokës së kërkuar nga ai si kompensim për parcelat e shitura nga AKP-ja dhe, për këtë arsye, Kolegji i Ankesave konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur një kërkesë të saktësuar në mënyrë të mjaftueshme që gjykata të vendosë për ndonjë kompensim.
41. Në fund, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara të përmendura në kërkesë përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk ka saktësuar se si janë shkelur nenet e përmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.
42. Bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata përfundon se parashtruesi nuk i ka dëshmuar pretendimet për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mbrojtje të pronës. Prandaj, kërkesa është qartazi e papabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2), (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 31 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović




Kryetarija e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi